



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 572/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Valstimir Dimić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në afersi të Qendrës së Votimit (QV) në ditën e zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e organizatës Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN).

Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënim me gjobë ne vlerë prej 4500 (katërmijepesëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga organizata BIRN, me te cilën pretendohet se më datë 12.12.2010 në qendrën e votimit 3016a në Malishevë gjatë tërë ditës që janë mbajtur zgjedhjet në hyrje të kësaj shkolle konkretisht në shtyllën për ndriçim si dhe në objektet përbashkët shkollës kanë qenë të vendosura postera nga kandidatët e PDK-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi si dëshmi, në të cilat shihet se posterat e subjektit politik PDK janë më afér se 100 metra nga Qendra e Votimit nr. 3016a në Malishevë.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik PDK, më datë 13.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 16.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar, në të cilën theksohet se gjatë fushatës paraelekторale për zgjedhjet e 12 Dhjetorit dhe as ditën e Votimit, nuk është vendosur ndonjë poster në objektet shkollore në Malishevë. Nga përgjigja në ankesë e subjektit politik PDK potencohet se fotot e prezantuara janë të vendosura nga një person i panjohur dhe menjëherë janë hequr në prezencën e Kryetarit të KKZ-së në Malishevë rrëth orës 06:30 të mëngjesit të 12 Dhjetorit.

Veprimet e Ndaluara Para Procesit të Votimit

36.1 Njëzetkatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjëren nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) *të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se subjekti politik PDK, ka vendosur posterat më afër se 100 metra QV-së të lartcekur dhe te cilët kanë qëndruar gjatë tërë ditës së zgjedhjeve. Subjekti politik PDK disa herë ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, rrëthanë e cila ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar në gjobë. Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim te nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 572/2010 më datën 14.12.2010

